REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 3266/11 Prot.

Lushnje, më 12/04/2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. 45
KËSHILLIT BASHKIAK

MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2024
(Miratuar me VKB nr.103 datë 21.12.2023)

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/____/ 2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë **"Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2024 ",** mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 germa dh, në Ligjin Nr.97/2023,"Për buxhetin e vitit 2024", në Ligjin nr.9936 date 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar.

PROPOZOJMË:

1. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2024 për vlerën 29,640,003 lekë.
2. Të rriten shpenzimet për vitin 2024 për vlerën 29,640,003 lekë.

Rritja do të shkojë në:

a) Në **Bashkinë Lushnje** në programin AC129 " Arsimi" (00-01-AC129-231) për 29,640,003 lekë, " Rikonstruksion i godinës dhe palestrës së shkollës së mesme Jani Nushi".

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financë-Buxhetit .
4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA FINANCË –BUXHETIT
Juljana HASALLA

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri HIDA

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes *Tel:+355 35 222139* *E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com*

2307
13.03.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1813/3 Prot.

Tiranë, më 11.03.2024

Lënda: Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin.

BASHKISË Lushnjë

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të nenit 15, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", urdhrit nr. 97, datë 08.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2024-2025, nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm" dhe programi "Për Sportin", për infrastrukturën shkollore e sportive", ju bëjmë me dije se jeni shpallur fitues për projektin/ projektet bashkëlidhur.

Konform legjislacionit të sipërcituar si dhe bazuar në:

1. Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014, i ndryshuar, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
2. Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
3. Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje, kolaudim".
4. Vendimin nr. 319, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", i ndryshuar.
5. Vendimin nr.216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
6. Vendimin nr.537, datë 08.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave".
7. Vendimin nr.26, datë 15.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".
8. Vendimin nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".

Pas miratimit të çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bashkia duhet të fillojë procedurat për realizimin dhe përmbushjen në afat të detyrimeve dhe pas realizimit të procedurave të prokurimit një kopje e kontratës së nënshkruar duhet të përcillet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

NINA GUGA

Nr.	Bashkia	Programi Buxhetor	Emërtimi i Projektit	Vlera e Plotë e Projektit	Financim nga NJQV	Financimi nga MAS 2024	Financimi nga MAS 2025
3	Lushnjë	9230	Rikonstruksion i godinës dhe palestrës së shkollës së mesme "Jani Nushi"	**118,560,014**	**29,640,003**	**30,000,000**	**58,920,011**
				118,560,014	29,640,003	30,000,000	58,920,011